



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,  
mbajtur më 8.2.2024, e cila filloj në orën 14:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Edmond Azemi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Tiera Kasumi-Berisha (LVV), (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Sami Salihu (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fikneta Bejtë (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Endrit Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Fehmi Kupina (i pavarur).

**Munguan:** Berat Lahu (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Violeta Salihu (LVV) dhe Agim Kuleta (LB).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkyetar i Komunës, Jehona Lushaku-Sadriu, nënkyetare e Komunës, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Donika Çetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, i cili tha se për këtë mbledhje është propozuar ky

### Faqe Inga5

## Rend i ditës:

1. Propozim-vendimin për anulimin e Vendimit nr. 01-020/04-236518/23, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Kongjelit, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 21.12.2023.

Kryesuesi hapi diskutimin, por fillimi shpesh kërkoi nga z. Gëzim Sveçla, si propozuesi i kësaj pike, që ta paraqesë arsyeshmërinë për anulimin e këtij vendimi.

Gëzim Sveçla tha se ky propozim përmban bazën ligjore në të cilën mbështetet edhe pjesa formale, ku shpjegohet se çfarë anulohet dhe cilët janë zyrtarët kompetentë për ekzekutimin e këtij vendimi. Ky këmbim në mënyrën si është paraqitur nga ekzekutivi, nuk i shërben të mirës së përgjithshme dhe si i tillë është i dëmshëm për pasurinë publike të qytetarëve të Prishtinës.

Argumente shtesë në favor të anulimit të këtij vendimi, janë edhe vlerësimi i ligjshmërisë, i bërë nga MAPL-ja pas bërjes publike të fakteve të reja, duke konkluduar se vendimi është i paligjshëm, ku udhëzohet Kuvendi Komunal i Prishtinës që brenda 30 ditësh ta rishqyrtojë këtë vendim. Gjithashtu, Gjykata Themelore në Prishtinë, siç jeni tashmë në dijeni, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi. Për këtë i falënderojmë të gjitha mediet që e kanë trajtuar, përkundër faktit se jo rrallë si subjekt politik, jemi sulmuar pa të drejtë e pa argumente, por mbështetet përfshirë mendësinë e vërtetë të kësaj qeverisje kjo është kostoja që duhet bartur. Ftojmë Prokurorinë dhe hetuesinë e shtetit që, pa marrë parasysh anulimin, ta trajtojë me prioritet dhe t'i vë në përgjegjësi të gjithë ata zyrtarë të zgjedhur apo të emëruar që pasurimin e shpejtë, apo shlyerjen e borxheve personale, duan ta arrijnë në dëm të pasurisë publike. I ftojmë gjithë asamblistët e qytetit, të të gjitha partive politike, që ta mbështesin propozimin tonë dhe të votojnë për anulimin e këtij vendimi.

Përparim Rama, kryetar, tha se ky vendim ka rrjedhur nga një proces, i cili ka filluar nga qeverisja e kaluar, pra jo nga Përparim Rama, për më tepër ky proces ka rrjedhur nga një numër i vendimeve nga niveli qendror, pra të Ministrisë së Ambinetit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal. Nga momenti që qeverisja jonë ka vazhduar këtë proces, janë ndjekur të gjitha procedurat e parapara ligjore, pra për këtë çështje janë dërguar pikat e rendit të ditës me kohë, përfshirë edhe këtë pikë për këmbim, por nuk ka reaguar askush; është diskutuar në KPF, nuk ka reaguar askush; është miratuar në këtë Kuvend dhe nuk ka reaguar askush. Kanë kaluar disa javë, asnjë fjalë nuk e ka thënë as LVV, as PDK e askush tjetër. Pas një shkrimi të pavërtetë dhe tendencioz, ju e politizuat dhe e personalizuat këtë çështje. Si pasojë e shkrimeve spekulative, të njëjtit zyrtar të Ministrisë së Pushtetit Lokal që kanë miratuar ligjshmërinë, të njëjtit e tërheqin atë pa asnjë argument shtesë, pa asnjë fakt shtesë!

Ministria e Financave thotë se pas informatave nga mediet, suspendojnë vlerësimin e pronave, d.m.th. as fakte nga prokuroria, as fakte nga policia, as ndonjë dëshmi tjetër të kërkuar nga Komuna.

**Doruntinë Maloku**, drejtore, tha se në vitin 2019 palët private kanë marrë kushtet ndërtimore për ndërtimin e një lagjeje pranë ligenit të Badovcit. Meqenëse shoqata të shumta për mbrojtjen e mjedisit janë ankuar dhe për shkak të presionit publik, Ministria e Ambientit në vitin 2020, e ka obliguar Komunën e Prishtinës që të anulojë vendimin e kushteve ndërtimore dhe ka kërkuar që ai ndërtim të mos bëhet, duke dhënë një mori arsyetimesh për mbrojtjen e ujit dhe zonës së mbrojtur të ligenit të Badovcit. Pas ankesës së palës, Ministria e Ambientit obligon organet komunale të Prishtinës, në koordinim me palën, që të veprojnë konform ligjt për shpronësimin e pronës së paluajtshmë. Komuna e Prishtinës në pamundësi për shpronësimin e pronës, ka tentua të bëjë këmbimin e kësaj prone dhe në dhjetor të vitit 2023 është bërë këmbimi i kësaj parcele me një pjesë të parcelës komunale. MAPL-ja më 9 janar të këtij viti, ka lëshuar konfirmimin e ligjshmërisë së këtij vendimi, mirëpo nga dita që ishte marrë vendimi i Kuvendit komunal, filloi ndërtimi i një kauze të mashtrimit të opinionit publik me dezinformata dhe Ministria e Financave, më 25 janar 2024, merr vendim që të pezullojë vlerësimin e këtyre pronave bazuar në raportimet e medieve. Ftojmë Prokurorinë Speciale që të zgjerojë, t'i analizojë këto çështje shumë serioze dhe të rëndësishme që e kanë përshkruar këtë proces.

**Nora Kelmendi** tha se në seancën e 21 dhjetorit 2023, Grupi i asamblistëve të LVV-së e ka kundërshtuar fuqishëm këtë pikë të rendit të ditës për shkak të shkeljeve të panumërtë. Ne si Grup parlamentar, më 15 dhjetor 2023, kemi kërkuar nga ekzekutivi i Komunës sqarime në lidhje me këmbimin për shkak të disa paqartësive, specifikisht për dy parcelat të cilat kanë qenë më herët objekt i këmbimit. Në shkresë ju kam treguar se dokumentet e bashkëngjitura janë të mangëta dhe të paelaboruara mirë. Si të tilla kanë shkaktuar konfuzitet dhe nuk mund të shqyrtohen nga ne si asamblistë të Kuvendit komunal të Prishtinës. Për këtë shkresë kemi pranuar një përgjigje, e cila ka qenë e pakuptimtë dhe e mangët. Në mbledhjen e KPF-së, mbajtur më 20 dhjetor 2023, ne si Grup parlamentar nuk kemi votuar për ndryshimet e pikave në rendin e ditës, kemi qenë kundër heqjes së pikave 3 dhe 4, nëse nuk tërhoqet pika 2 e rendit të ditës. Kundërshtoj publikisht dhe iu tregoj të gjithëve se kundërshtimi ynë si Grup i LVV-së, është bërë në fillim përmes dërgimit të shkresës zyrtare, pra përmes e-mailit në ekzekutiv dhe tek ju në KPF, ku e kemi kundërshtuar pikën 2 dhe më vonë në seancë. Pra shfaqjet tuaja tanë edhe në TV, që mundoheni të arsyetooheni se nuk keni pasur kundërshtime nga askush, nuk janë të vërteta dhe nuk qëndrojnë.

**Jeta Rafuna** tha se Grupi i asamblistëve të LDK-së qëndron prapa qëndrimeve dhe faktave të prezantuara nga kryetari Rama dhe drejtoresha e Drejtorisë së Pronës. Kjo seancë është thirrur nga subjektet që kanë mundësuar këmbimin e kësaj prone komunale dhe si e tillë kërkesa e thirrësit të seancës nuk ka argumente ligjore, por është kryekëput e motivuar politikisht për ta goditur kryetarin Rama. Ne si Grup i asamblistëve të LDK-së, presim që gjykata ta japë verdiktin e saj final për tërë këtë proces, prandaj ne nuk bëhem pjesë e kësaj vendimmarrje pa argumente ligjore, që në të ardhmen mund ta cenojnë interesin publik të Komunës së Prishtinës.

#### Faqe3nga4

*Pas diskutimit të znj. Rafuna, GP i LDK-së dhe përfaqësuesit e ekzekutivit të Komunës e lëshuan mbledhjen.*

**Leutrim Retkoceri** tha se ky vendim, i cili është miratuar në sencën e dhjetorit 2023, përmendimin tonë nuk ka arsyetuar interesin publik. Ne ishim dhe jemi kundër ndërtimeve në Badovc dhe nuk mendoj që Komuna iu ka borxh pronarëve të pronave private, t'ua ndërroj tokat pa e arsyetuar interesin publik. Ne nuk e përkrahim këtë këmbim të pronës në Badovc. Aspak nuk na shqetësojnë pozicionet politike të partive tjera, por e rrezikshme është që fenomeni i tillë i dëmshëm të kthehet në normalitet. Tanimë pezullimin e këtij vendimi e ka bërë Gjykata Themelore në Prishtinë, pas padisë të cilën e ka ngritur Instituti Kosovar për Drejtësi, ku kjo gjykatë ka shpallur masën e pezullimit të vendimit, që na jep të drejtë në qëndrimin tonë të hershëm, se ky vendim është i dëmshëm. Partia Demokratike e Kosovës, voton përfshirë shfuqizimin e vendimit të këmbimit të pronave në Badovc.

**Bahri Gashi** tha se është për të ardhur keq që LDK-ja dhe kryetari me gjithë ekzekutivin e lëshuan sallën. Mendoj se është gabim i madh çka është duke bërë ekzekutivi, por pavarësisht asaj kjo seancë vazhdon.

**Gëzim Mehmeti** tha se të akuzosh mediet përfshirë që cilat ke gabuar vetë, kjo kupton se në çfarë niveli ka ardhur qeverisja e Komunës së Prishtinës, andaj nuk ndihem aspak i kënaqur se në këto momente nuk janë pjesëtarët e ekzekutivit.

**Endrit Zabërgja** tha se arsyaja pse Nisma Socialdemokrate nuk ka qenë pjesë e votimit në vitin 2021, e as në votimin e fundit, është se kemi konstatuar paqartësi në proces dhe duke pasur parasysh se ka pasur shumë palë të përfshira në këtë proces.

Në seancën e dhjetorit 2023, po të mos kishin qëndruar në sallë përfaqësuesit e PDK-së dhe përfaqësuesit e LVV-së kjo pikë nuk do të kalonte dhe sot nuk do të ishim në mjegulli të informacionit. Ajo çka unë besoj se është e rendësishme, është që ta dimë dhe ta kuptojmë se në këtë asamble komunale interesi madhor, interesi i vetëm është interesi publik dhe interesi qytetar dhe kur te kemi përnjëmend interesin qytetar, duhet të jemi konsistent me qëndrime dhe jo ato qëndrime t'i personalizojmë varësisht se qysh na konvenojnë neve, dhe nëse e kemi pasur përnjëmend kundërshtimin, është dashur ta kundërshtojmë në mënyrë të vazhdueshme.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u anulua Vendimi për anulimin e Vendimit numër 01-020/04-235618/23, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 21.12.2023.

*P.S. Sipas deklaratës së dhënë të znj. Shegë Beqiri, (PDK), më 14.2.2024, dhe të z. Bahri Gashi, (AAK), më 15.2.2024, thuhet se: Në aparturën e votimit nuk janë regjistruar vota e tyre, ku në fakt kanë votuar përfshirë qëndrime t'i personalizojmë varësisht se qysh na konvenojnë neve, dhe më 29 vota për.*

*Mbledhja përfundoi në orën 15:10.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Pëllumb Bajçinovci

Faqe4nga4

